

AKT THEMELIMI

I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"IGT GROUP"- sh.p.k

Mbeshtetur ne Kushtetuten dhe Kodin Civil ne fuqi te Republikes se Shqiperise, te ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe te ligjit Nr.9723 date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", me vullnetin e tyre te lire, te shprehur edhe ne nenshkrimin e ketij Akt Themelimi ne ortaket:

1. **Znj.Alba Dervishi**, lindur me 01.05.1980, ne Tirane dhe banues ne Tirane, madhore me zotesi te plote per te vepruar, me kombesi dhe shtetesi Shqiptare, e identifikuar me ane te kartes se Identitetit me nr. personal I05501081K **ne cilesine e ortakut themelues**
2. **Z.Ervis Kozak**, lindur me 07.05.1982, ne Berat dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote per te vepruar, me kombesi dhe shtetesi Shqiptare, i identifikuar me ane te kartes se Identitetit me nr.personal I20507084K, **ne cilesine e ortakut themelues**
3. **Z.Artur Kurti**, lindur me 04.03.1975, ne Tirane dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote per te vepruar, me kombesi dhe shtetesi Shqiptare, i identifikuar me ane te kartes se Identitetit me nr.personal H50304061W, **ne cilesine e ortakut themelues**

Vendosem te krijojme shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar **"IGT GROUP"sh.p.k** me akt themelimi si vijon:

EMERTIMI

NENI 1

- 1.1 Formohet shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar e quajtur **"IGT GROUP" sh.p.k**.
- 1.2 Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqiptar, ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit te vendit ku do te kete seline dega. Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaket themelues.

SELIA E SHOQERISE

NENI 2

- 2.1 Shoqeria e ka seline qendrore **ne adresen Rruga "Sami Frasheri", Godina Nr.32, Njesia Bashkiake Nr.5, Tirane** dhe gezon te drejten per te hapur filiale ose dege te tjera ne Shqiperi dhe jashte saj.
- 2.2 Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale si brenda dhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te asamblese dhe ortakeve.

Alba Dervishi

ARTUR KURTI

Ervis Kozak

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 3

3. Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushat e:

3.1 Aktivitet ne fushen e informatikes, projektim, dizenjim zhvillim dhe mirembajtje sistemesh software, testim software, dizenjim dhe zhvillim sistemesh te komunikimit, dizenjim dhe zhvillim sistemesh migrimi, permiresim/upgrade sistemesh informatike, operim, menaxhim suport perdorimi, trajnim, auditim teknik/informatik per sistemet software.

3.2 Tregtimin e produkteve software dhe hardware duke perfshire, por pa kufizuar, per: sistemet informatike; sistemet e telekomunikacionit; dhe/ose sistemet dhe/ose aparaturave dixhitale.

3.3 Trajnime dhe kurse te formimit profesional ne fushen e informatikes, hartografise digitale dhe GIS. Kurse trajnimi per nivele te ndryshme ne fushen e informatikes (manaxher, specialist, perdorues, trajnues, etj).

3.4 Aktivitet i telemarketingut (web call center), per klient te huaj apo shqipetar te cilet vleresojne marketizimin e produkteve apo sherbimeve te tyre nepermjet kesaj forme marketingu.

3.5 Import-exporte makinerish, shitje makinerish industriale dhe kompjuterash, makina elektrike, bicikleta, monopatina si dhe cdo pjese kembimi elektronike dhe elektrike.

3.6 Suport dhe ndermjetesime per shoqeri te huaja dhe vendase per krijimin e planeve te biznesit, star-up, menaxhim projektesh, zbatim projektesh etj.

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

NENI 4


4.1 Shoqeria "IGT GROUP" sh.p.k do te ushtroje aktivitetin ekonomik te saj, per nje periudhe kohe te pakufizuar nga data e regjistrimit te saj prane Q.K.B.


KAPITALI I SHOQERISE


NENI 5

5.1. Kapitali i shoqerise "IGT GROUP" sh.p.k perbehet nga para me nje vlere te barabarte me 10 000 leke. Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme:

5.1.1 Ortaku themelues **Alba Dervishi**: Zoteruese i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 3000 leke qe perben 30% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Alba Dervishi


ARTUR KUET


EMIR KODRICA


5.1.2 Ortaku themelues **Ervis Kozak**: Zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 4000 leke qe perben 40% te kapitalit themeltar te shoqerise.

5.1.3 Ortaku themelues **Artur Kurti**: Zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 3000 leke qe perben 30% te kapitalit themeltar te shoqerise.

5.2. Kapitali themeltar mund te rritet pa kufi ne çdo moment, nje ose disa here, me vendim te asamblese se ortakeve i cili eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

5.3. Ne rast rritjeje te kapitalit, te gjithë ortaket kane te drejte te nenshkruajne rritjen ne raport me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre. Ne rast se nje apo disa nga ortaket nuk e ushtrojne kete te drejte, pjeset qe i rezervohen atij/atyre ne rritjen e kapitalit mund te nenshkruhen nga ortaket e tjere proporcionalisht me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre.

5.4. Shoqeria mund te zvogeloje kapitalin themeltar me vendim te asamblese se ortakeve organi i vetem vendimmarres i shoqerise. Ne çdo rast kapitali themeltar nuk mund te zvogelohet nen kufirin qe percakton ligji. Zvogelimi i kapitalit perballohet nga secili prej ortakeve ne te njejten mase me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre.

ORGANI VENDIMMARRES

NENI 6


6.1. Organi vendimmarres i shoqerise eshte asambleja e pergjithshme e ortakeve:


6.2. Asambleja e ortakeve me tre të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës ($\frac{3}{4}$) vendos per çeshtje si :


- a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- c) emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- ç) percaktimin e shperblimeve;
- d) mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- f) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- g) ndryshimin e statutit, e selise se shoqerise, hapjen dhe mbylljen e filialeve te saj.
- h) zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te shoqerise;
- i) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise etj.

6.3. Te gjitha vendimet e marra nga asambleja e pergjithshme duhet te regjistrohen ne librin e procesverbaleve sipas nenit 90 te ligjit nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

6.4 Njoftimi duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites dhe tu dergohet ortakeve jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Alba Demish


ARTUR KURTI


ERVIS KOZAK


6.5 Asambleja e Perjithshme emeron nje ose me shume persona fizik si administrator te shoqerise Afati i emertimit eshte 1 vjet, me te drejte riperteritje. Emertimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

6.6 Ortaket themelues unanimisht vendosin te caktojne si Administrator te pare te shoqerise "IGT GROUP" shpk deri ne mbledhjen e pare te asamblese se pergjithshme:

Znj. Alba Dervishi

DREJTIMI I SHOQERISE

NENI 7

7.1 Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj, nga ortaket dhe perfaqesuesi ligjor i saj. Administratori dhe ortaket jane perfaqesuesit e Shoqerise ne marredhenie me te tretet dhe kane kompetenca te plota ne drejtimin e saj.

7.2 Cdo kontrate do te kryhet prej tyre dhe ne rast mungese Shoqeria do te perfaqesohet nga nje perfaqesues i pajisur me prokure te posacme.

NENI 8

8.1 Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakeve bazuar ne kuotat qe ata zoterojne.

NENI 9


9.1 Ortaket themelues kane te drejte te emerojne dhe administrator te tjere, kane te drejte te caktojne financiere, likuidator per problemet e shoqerise si dhe te pajtojne persona te tjere si ortake, sipas kushteve dhe kriterëve te percaktuara ne statut.


NENI 10


10.1 Konfliktet qe mund te lindin do te zgjidhen ne zbatim te legjislacionit Shqiptar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane.

NENI 11

11.1 Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme, me tekstin rreth saj.

Alba Dervishi


ARTUR KURTI


Enis Ismaili


NENI 12

12.1 Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi dhe vecanerisht te Ligjit Nr. 9901 date, 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", si dhe duke zbatuar ligjet nderkombetare dhe te vendit si dhe rregullave qe zbatohen per biznesin qe kryen kjo shoqeri.

NENI 13

13.1 Akti i Themelimit u perpilua ne 4 kopje, 5 (pese) faqe gjithsej per t'ju shperndare organeve kompetente. Akti i Themelimit nenshkruset rregullisht nga ortakët themelues.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

"IGT GROUP"- sh.p.k :

1. Alba Dervishi

Alba Dervishi

2. Ervis Kozak

Ervis Kozak

3. Artur Kurti

ARTUR KURTI

AK

Tirane me dt 26.01.2022